



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 7

Tiranë – E hënë, 22 shkurt 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 3178, datë 15.2.2021	Për marrjen pjesë në tryezat e diskutimit dhe të këshillimit, në kuadër të procesit të integritetit evropian..... 3
Kërkesë e Agjencisë së Trajtimit të Pronave nr. 1539, datë 18.2.2021	Për publikimin e regjistrit të vendimeve, të cilat kanë njohur të drejtën për kompensim dhe të vlerësimeve për vitet 1994, 1995, 1996 dhe 2006..... 4
Kërkesë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 1636/2, datë 22.2.2021	Për marrjen e ambienteve me qira për zyra, për nevoja sistemimi të stafit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit..... 6



NJOFTIM

Nr. 3178, datë 15.2.2021

**PËR MARRJEN PJESË NË TRYEZAT
E DISKUTIMIT DHE TË KËSHILLIMIT,
NË KUADËR TË PROCESIT TË
INTEGRIMIT EVROPIAN**

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019, “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian”,

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e institucionit drejtues të kapitujve:

- kapitulli “Kriteri ekonomik”;
- kapitulli 1, “Lëvizja e lirë e mallrave”;
- kapitulli 2, “Lëvizja e lirë e punëtorëve”;
- kapitulli 3, “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime”;
- kapitulli 6, “Legjislacioni për shoqëritë tregtare”;
- kapitulli 7, “E drejta e pronësisë intelektuale”;
- kapitulli 16, “Tatimet”;
- kapitulli 20, “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”;
- kapitulli 28, “Mbrotja e konsumatorit dhe e shëndetit publik”;
- kapitulli 29, “Doganat”;
- kapitulli 30, “Marrëdhëniet me jashtë”;
- kapitulli 32, “Kontrolli financiar”;
- kapitulli 33, “Financat dhe buxheti”.

Fton të marrin pjesë lirisht në tryezat e diskutimi dhe të këshillimit, në kuadër të procesit të integrimit evropian, të cilat krijohen në mënyrë analoge me kapituj e *acquis* të Bashkimit Evropian, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të

punëmarrësve, të botës akademike, të medias dhe të grupeve të interesit, referuar përcaktimeve të kreut III.2, pika 4, të urdhrit.

Sipas përcaktimeve të kreut III.2, të urdhrit të Kryeministrit, aplikimi për t’u bërë pjesë e tryezave të diskutimit dhe të këshillimit kryhet nëpërmjet dorëzimit të një letre interesi, si dhe CV-së së personit apo të grupimit që përfaqëson, duke treguar se kanë ekspertizën apo interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në tryezat specifike.

Personat apo përfaqësuesit e grupeve të interesit mund të paraqesin dokumentacionin e sipërcituar për pjesëmarrje, brenda datës 15 mars 2021, në adresat e mëposhtme elektronike të sekretariateve teknike të GNP-së, sipas kapitujve më poshtë:

- Kapitulli 3, “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime”; kapitulli 20, “Ndërmarrjet dhe politikat industriale” dhe kapitulli “Kriteri ekonomik”: Kevin.Treska@financa.gov.al.

- Kapitulli 6, “Legjislacioni për shoqëritë tregtare”; kapitulli 16, “Tatimet” dhe kapitulli 30, “Marrëdhëniet me jashtë”: Kejsi.Kazia@financa.gov.al.

- Kapitulli 7, “E drejta e pronësisë intelektuale”: Sonila.Meka@dppi.gov.al.

- Kapitulli 2, “Lëvizja e lirë e punëtorëve”, kapitulli 29, “Doganat” dhe kapitulli 32, “Kontrolli financiar”: Rezarta.Dashi@financa.gov.al.

- Kapitulli 1, “Lëvizja e lirë e mallrave”, kapitulli 28, “Mbrotja e konsumatorit dhe e shëndetit publik” dhe kapitulli 33, “Financat dhe buxheti”: Marinela.Guce@financa.gov.al.

Përzgjedhja e personave apo e përfaqësuesve të grupeve të interesit do të bëhet, sipas urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019.



KËRKESË
Nr. 1539, datë 18.2.2021

PËR PUBLIKIMIN E REGJISTRIT TË VENDIMEVE, TË CILAT KANË NJOHUR TË DREJTËN PËR KOMPENSIM DHE TË VLERËSIMEVE PËR VITET 1994, 1995, 1996 DHE 2006

[illegible]



Problematika/ Mungesi dokumentacioni	Dok. i ligjor për përcaktimin e z.kadastral të origjinës	Sip. e këtyer (kompensuar fqetisht) përfundimtare					Sipërfaqja m2 totale	Sip. për kompensim përfundimtare					Zeri kadastral aktual				VLERESIMI
		Sipërfaqja m2 totale	Zeri kadastra l Traulli	Zeri kadastra l toke bujqësor	Zeri kadastra l kalibër	Zeri kadastra l Pyll		Zona Kadastra ale	Zeri kadastra l Traulli	Zeri kadastra l toke bujqësor	Zeri kadastra l kalibër	Zeri kadastra l Pyll	Zona Kadastra ale	Zeri kadastra l Traulli	Zeri kadastra l toke bujqësor	Zeri kadastra l kalibër	
Vendimi nr. 450, datë 29.10.2020 të Gjykatës së Reutit Gjyqësor Lezhë me të cilin është provuar vërtetësisht e dokumentit (planvenditje) - Ndërkohë të kategorisë të vlerësuar të vendimit në regjistrin nga "Për plotësimin subjektit" në "Përfundimtare"	Sipas hartës me viti me të afert me përcaktimin e shprehurimit të depozituar nga subjektin viti 1963 me krahun nr.1477 dh.21.06.2017-ai dhe hartës Vija e Vendlës e Qendrës Lezhë viti 1964 prona e kësaj krahë vija kufitare të ndërtimit, trulli.						892	892	0	0	0	8631	892	0	0	0	7,591,812
Edhe vlerësuar për kompensim edhe sipërfaqja prej 1066 m2 që trajton vendimin nr.16 dhe përcaktimin, të përcaktimit regjistrin duke u rregulluar vlera e sipërfaqes me të drejtë kompenzimi : 2444 m2 x 10905 l/m2 = 26,646,932 lekë	Referuar vendimit të Gjykatës nr.2767 datë 28.12.2005, sipërfaqja ndërtimore prej 1200 m2 dhe sipërfaqja funksionale për pjesën tjetër						3510	3510	0	0	0	8602	3510	0	0	0	26,646,932
Edhe vlerësuar për kompensim edhe sipërfaqja prej 1066 m2 që trajton vendimin nr.16 dhe përcaktimin, të përcaktimit regjistrin duke u rregulluar vlera e sipërfaqes me të drejtë kompenzimi : 2444 m2 x 10905 l/m2 = 26,646,932 lekë	Referuar vendimit të Gjykatës nr.2767 datë 28.12.2005, sipërfaqja ndërtimore prej 1200 m2 dhe sipërfaqja funksionale për pjesën tjetër						3511	3511	1	1	1	8603	3511	1	1	1	26,646,933
1-Vendimi Nr.1266 dh.22/10/1996 ish pronar Lutfije Ballushi ka mbivendosje të gjendur rreth 38 m2 me vendimin Nr.607 dh.08/01/1996 ish pronar Vangjelica Ballaneci.	Trulli sipas hartës 1937. Vërtetimi prona nga regjistrin depozituar nr. 609, dh. 29.08.1925-shëpi. Trulli sipas hartës 1937.						275.8	275.8	0	0	0	8160	275.8	0	0	0	18,466,702
2-Vendimi Nr.1163 dh.26/09/1998 ish pronar Dini Raposhi ka mbivendosje të gjendur rreth 1 ha2 me vendimin Nr.607 dh.08/01/1996 ish pronar Vangjelica Ballaneci.	Referuar vendimit prona nr.273 datë 09.10.1970 shëpi.	110	110				8160	88	88	0	0	0	8160	88	0	0	5,893,272
Vendimi nr. 311 datë 16.04.1998, të Gjykatës së Reutit Lezhë, i cili ka ndryshuar vendimin nr. 197 datë 07.04.1993, të ish KKKP Baskin Lezhë, në anë të subjektit të shprehuruar Qmë Kërcira. Sip. prej 10'000 m2 i është shtuar e drejta e kërkimit sip. prej 14'983 m2 i është shtuar e drejta e kompenzimit. Të përcaktimit regjistrin duke u rregulluar vlera e sipërfaqes me të drejtë kompenzimi 4,363,812 lekë.	Referuar vendimit nr.728 dh.25.05.1994 vërtetimi e faktit prona për sipërfaqja 4983m2. Vendimi nr.1006 dh.27.07.1994 vërtetimi e faktit prona për sipërfaqja 20000m2. Nuk përcaktohet zeri kadastra l origjinës. Zeri Kadastra l shëpi përcaktohet nga Harta IGJF-Topo-50000. Referuar vendimit nr.728 dh.25.05.1994 vërtetimi e faktit prona për sipërfaqja 4983m2. Vendimi nr.1006 dh.27.07.1994 vërtetimi e faktit prona për sipërfaqja 20000m2. Nuk përcaktohet zeri kadastra l origjinës. Zeri Kadastra l shëpi përcaktohet nga Harta IGJF-Topo-50000.						11498.00	0	11498	0	0	1047	11498	0	0	0	4,363,812
Mbivendosje me V. 79 dh. 16.03.1995 - Mbivendosje 520m2 total ku 500m2 janë këtu dhe pjesa tjetër kompenzimi.	Referuar Hartës IGJF viti 1941 zeri i origjinës edhe krahë bujqësor.						1120	0	1120	0	0	3362,8601	1120	0	0	0	228,480
Prona mbledhur në dy zona kadastrale me dh.8592 dhe dh.8593 Shkollor. Për këtë shtetë këtu u krahësi i përcaktimit të kësaj përcakte në sistemin Web-çës. Për këtë shtetë të përcaktimit regjistrin përcakte.	note transkriptimi/ trulli	shtepi pa sip	shtepi pa sip.				8594	591 (171 kom. + 420 paraqelje)	591			8594	591				2,090,133
Të përcaktimit regjistrin përveç i përcaktimit të V. 1146 dh. 30.12.1996, ish KKKP Trina si dhe vlerësimi financiar i pronës trajtuar me këtë vendim	Referuar dokumentacionit ligjor me doje vërtetimi prona datë 25.07.1993 nga Hapështja Vllamë konstatohet se i regjistruar ligjorë nr.431 dh. 18.06.1942 (në prona të Z. Selman Huta figuron e regjistruar gjyqësor e përcakte e krahësi të shëpi, me sip. 3550 m2 për një numër të përcaktimit zeri kadastra l origjinës në prona. Nuk ka dokumente shprehurimi në doje. Referuar hartës në gjyqësor viti 1937-1938. Trulli.						8150	1850				1850					123,892,650
Krijon mbivendosje prej 8m me V.683 Dh. 03.03.1995.	vendim Komiteti Ekzekutiv nr.227 dh.28.12.1985						206.2	206.2	0	0	0	8563	206.2	0	0	0	1,553,717

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Jonida Baçi

**KËRKESË**

Nr. 1636/2, datë 22.2.2021

**PËR MARRJEN E AMBIENTEVE ME
QIRA PËR ZYRA, PËR NEVOJA
SISTEMIMI TË STAFIT TË
KOMISIONIT TË PAVARUR TË
KUALIFIKIMIT****I. Kriteret ligjore që duhet të plotësojnë
ofertuesit**

1. Të jenë titullarë të ligjshëm të pronës së vërtetuar me certifikatë pronësie, lëshuar nga ASHK-ja bashkë me kartelën dhe hartën shoqëruese të pronës, si dhe genplanin;

2. Vërtetim hipotekor që prona nuk është në sekuestro dhe është e lirë nga çdo barrë hipotekore apo detyrim tjetër ligjor, lëshuar nga ASHK-ja;

3. Vërtetim nga FSHU-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit të energjisë elektrike;

4. Vërtetim nga UKT-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit nga ujësjellës-kanalizimet;

5. Vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo në proces gjyqësor;

6. Nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe:

a) vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera;

b) vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera nga *e-Sigurime*;

c) ekstrakt QKR-je që vërteton se ka status aktiv;

7. Vetëdeklarim për plotësimin e të gjitha kërkesave dhe të kriterëve ligjore-teknike, që kërkojnë nga KPK-ja (qiramarrësi);

8. Kopje ID-së e titullarit të pronës/ambienteve;

9. Vërtetim të numrit të llogarisë bankare në një nga bankat e nivelit të dytë në RSH;

10. Ofertë me shkrim e çmimit të qirasë së ambienteve, në muaj.

II. Kërkesat specifike të ambienteve objekt qiramarrjeje

1. Sipërfaqja në total e ambienteve të brendshme të jetë 100 m²–150 m²;

2. Ambientet mund të ofrohen nga 1 ose maksimumi 2 qiradhënës të pronës, por në total i

gjithë ambienti duhet të jetë jo më shumë se sa sipërfaqja e parashikuar në pikën 1, kreu II.

3. Ambienti duhet të jetë sa më pranë godinës ekzistuese dhe jo më shumë se 100 metra në vijë ajrore larg godinës ish-Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Rruga e Kavajës, Tiranë.

4. Preferohet që, nisur nga rëndësia e institucionit, objekti duhet të ndodhet pranë dhe nën mbikëqyrjen e vendrojave të godinës ekzistuese të KPK-së dhe ONM-së.

5. Objekti/ambientet duhet të kenë të instaluar sistemin e vëzhgimit me kamera brenda dhe jashtë.

6. Objekti duhet të ketë të veshur sipërfaqen e xhamave me adeziv, i cili të lejojë pamjen nga brenda-jashtë dhe të pengojë pamjen nga jashtë-brenda.

7. Ambientet e brendshme të jenë *Open Space*, të përshtatshme dhe të ofrojnë funksionalitet/ndarje për të sistemuar postet e punës së punonjësve të KPK-së.

8. Objekti duhet të ketë furnizim me ujë dhe energji elektrike 24/7 dhe të jetë i pajisur me matësit e ujit dhe të energjisë elektrike.

9. Objekti duhet të jetë i përfunduar me dyer, dritare, i lyster dhe i gatshëm/i lirë për t'u shfrytëzuar nga qiramarrësi.

10. Objekti/ambientet duhet të ketë sistem kondicionimi dhe ajrimi, të instaluar dhe plotësisht funksional.

11. Objekti/ambientet duhet të kenë rrjet interneti të instaluar, si dhe rrjetin e prizave të energjisë elektrike.

12. Ambientet duhet të jenë bosh dhe të lira; dorëzimi i objektit do të bëhet brenda 7 ditëve nga njoftimi për lidhje kontrate.

13. Ambientet/objekti, në total duhet të kenë minimalisht 2 tualete të kompletuara me pajisjet hidrosanitare dhe pajisjet për ujë të ngratë.

14. Ofertuesi duhet të përcaktojë çmimin (oferta ekonomike), vlerën mujore të qirasë për një muaj, duke përfshirë të gjitha detyrimet tatimore, sipas legjislacionit në fuqi.

15. Pagesa e qirasë do të bëhet çdo muaj në lekë, brenda datës që palët do të bien dakord në kontratën me shkrim.

16. Afati i kontratës së qiradhënies të jetë jo më pak se një vit me të drejtë rinovimi. Afati do të përcaktohet gjithmonë nga qiramarrësi, i cili



njofton me shkrim 30 ditë para mbarimit të kontratës qiradhënësin.

III. Paraqitja e dokumenteve dhe ofertës së qirasë së ambienteve

1. Dorëzimi i dokumenteve dhe i ofertave ekonomike duhet të bëhet brenda datës 26 shkurt 2021, ora 16:00, me postë ose dorazi, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, godina ish-Lidhja e Shkrimtarëve

dhe Artistëve të Shqipërisë, Rruga e Kavajës, Tiranë.

2. Për çdo komunikim apo sqarim, lutemi na shkruani në adresën elektronike: info@kpk.al ose kontaktoni në numrin cel.: 069 26 20 200.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Edmond Verçani

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2021